

V E N D I M
Nr. 131, datë 29.1.2003

**MBI HEQJEN DHE REDUKTIMIN E KOHËS SË VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE PËR
DISA SUBJEKTE TELEVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 7/21, nenit 33/5 dhe nenit 137 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të vendimit nr. 125, datë 27.11.2002 të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, ky i fundit

V E N D O S I:

1. T’i heqë licencën subjektit “Radio Jon” (neni 34, pika 5).
2. T’i reduktojë kohën e vlefshmërisë së licencës nga 5 vjet në 4 vjet subjekteve televizive TV ATN 1, TV Alba, TV Drini, TV Kukësi dhe TV Bajram Curri.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela